



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 144 Prot.

Tiranë, më 30.01 2018

VENDIM Nr. 13, datë 18.01.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi *Relacionin e vlerësimit (Proces-verbal) për strukturat arkeologjike të zbuluara, në gjendjen e sotme*, për sheshin e zhvillimit të projektit "Godinë banimi me 5 Kate dhe 1 kat nën-tokë " në lagjen Nr.1, rruga " Mbretëresha Teuta", në zonë arkeologjike "B", Durrës, paraqitur nga grupi i ekspertëve, në vijim të vendimit të KKA Nr. 230, datë 15.12.2017-subjekti "REI" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Relacionin e vlerësimit (Proces-verbal) për strukturat arkeologjike të zbuluara, në gjendjen e sotme*, për sheshin e zhvillimit të projektit "Godinë banimi me 5 Kate dhe 1 kat nën-tokë " në lagjen Nr.1, rruga " Mbretëresha Teuta", në zonë arkeologjike "B", Durrës, paraqitur nga grupi i ekspertëve, me kushtet përkatëse në vijim të kësaj pike.
2. Të ruhet ruhet *in situ* struktura e furrës Nr. 104, e zbuluar gjatë gërmimit arkeologjik të shpëtimit, duke marrë masat e nevojshme për mosdëmtimin e saj, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me projektin e ruajtjes dhe restaurimit të saj.
3. Të çmontohen pjesët dhe elementët e mbetur, të strukturave të furrave Nr. 103 dhe Nr. 106, duke parashikuar në projektin e ruajtjes dhe restaurimit restaurimit të sipërpërmendur edhe ekspozimin e tyre pranë strukturës së furrës 104.
4. Të depozitohet pranë ASHA projekti i ruajtjes dhe restaurimit të strukturës së furrës Nr. 104 dhe ekspozimit pranë saj të strukturave të furrave Nr. 103 dhe 106, për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKA e radhës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

5. Të depozitohet pranë ASHA projekti ndërtimor i ndryshuar, i cili do të marrë parasysh integrimin e furrës 104, e cila do të ruhet *in situ*, si dhe ekspozimin pranë saj të pjesëve dhe elementëve të mbetur të furrave të tjera, për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKA e radhës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al